06

Shoqërues
Eupelda Sefo

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE
KOMISIONI I SHPRONËSIMEVE

Nr 11051 Prot

Lushnje, më 15/12/2025

RELACION

PËR SHFUQËZIMIN E PIKËS 2 DHE 4 TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK ME NR.60 DATË 30.06.2025 QË PREKEN NGA PROJEKTI " SISTEMIMI I SHESHIT DHE TREGUT FRUTA PERIME NË LAGJIEN , "SKËNDER LOBOHOVA , RRUGA PAVARËSIA ".

Të nderuar Zonja dhe Zotërinj Këshilltarë!

Bashkia Lushnje është në prag të investimit për "Sistemimin e sheshit dhe tregut fruta perime në lagjen 'Skëndër Libohova , rruga Pavarësia". Hapësira e tregut aktual ndodhet në kryqëzimin e ypsilonit në bllokun e banimit , lagjja "Skënder Libohova. Lidhet me qëndrën e qytetit të Lushnjes nëpëmjet rrugës "Pavarësia". Gjendja e tregut aktual nuk i plotëson kushtet e funksionimit normal duke penguar kalimin e qytetarëve . Në këtë bllok banimi nevojiten vende parkimi , hapësira pushimi të qeta , hapsira të gjelbëruara dhe një treg i ri për fruta perime në kushte optimale , për të ofruar shërbime më të mira për qytetarët dhe bizneset e zonës.

Në projekt parashikohet ndërtimi i tregut fruta-perime, sistemimi i shesheve , largimi i drejtuar i ujërave të shiut, ndriçimi i objektit. Në tregun fruta – perime janë parashikuar të vendosen 10 njësi shitje. Ato janë të kompozuara për të formuar njësi tregëtimi të veçanta. Skema e qarkullimit përbëhet nga një korridor qëndror për shpërndarje nga të dyja krahët. Në raste të veçanta kur kërkohet rritja e kapacitetit, tregëtar të tjerë mund të akomodohen në perimetërin nën strehën e objektit. Tezgat përgjatë trotuarit sistemohen në hapsirat e tregut të ri duke liruar trotuarin qytetarëve.

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

Për verifikimin e dokumentacionit të pasurisë ku do të kryhet investimi është kërkuar statusi juridik i pronës nga A.SH.K Drejtoria Vendore Lushnje . Pronarëve u është kërkuar dokumentacioni përkatës që disponojnë për titullin e pronësisë. Referuar shkresës së ardhur nga Agjensia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Lushnje datë 26.08.2025 mbi statusin juridik të pasurive, rezzulton se pasuria me nr.7/8 dhe pasuria me nr.7/198 janë pasuri me informacion nga Libri i Ngastrave (i cili është infromacion orientues). Ky informacion ka karakter orientues siç e përcakton vetë ASHK dhe nuk ka fuqi ligjore dhe nuk mund të shërbejë si bazë për vendimarrje. Për këto arsye kërkojmë të hiqen nga lista për shpronësim pasuria me nr.7/8 ZK 8572 dhe pasuria me nr.7/198 ZK 8572 duke shfuqëzuar pikën 2 dhe 4 të VKB- së nr.60 datë 30.06.2025

Për realizimin e investimit duhet të shpronësohen pronarët sipas tabelës bashkëngjitur.

KRYETARI I KOMISIONIT

Edlira Mezini

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LUSHNJE

KOMISIONI I SHPRONËSIMEVE

Nr 11051/1 prot

Lushnje 15/12/2025

PROJEKT-VENDIM

NR. 115 DATË 15/12/2025

"PËR SHFUQIZIMIN E PIKËS 2 DHE 4 TË VENDIMIT TË KËSHILLIT BASHKIAK ME NR.60 DATË 30.06.2025 , TË PASURIVE QË PREKEN NGA PROJEKTI SISTEMIMI I SHESHIT DHE TREGUT FRUTA PERIME NË LAGJJEN , 'SKËNDER LIBOHOVA , RRUGA PAVARËSIA ".

Këshilli i Bashkisë Lushnje, në mbledhjen e datës___/___/2025,pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Komisioni i Shpronësimeve në Bashkinë Lushnje, i ngritur me Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 8, nenit 9 pika 1.2 germa "a"," b", neni 23 pika a të ligjit nr 139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjit Nr.8561 date 22.12.1999 "Për shpronësim dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurive pronë private për interes publik, të ndryshuar neni 7, neni 8 dhe neni 9; VKM nr.127,datë 23.3.2000 "Për përmbajtjen dhe procedurat e paraqitjes së kërkesës dhe të njoftimit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik; VKM nr.138,datë 23.3.2000 "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", **JU** :

PROPOZOJMË:

Adresa:Lagjia "Kongresi " Tel:+355 35 222139 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

1.Të hiqet nga lista shpronësimit për interes publik pasurinë private me nr.7/8 e ndodhur në ZK 8572 që preket nga projekti "Sistemimi i sheshit dhe tregut fruta perimeve në lagjjen 'Skënder Libohova , rruga Pavarësia" në vlerën 2,417,040 lekë.

2.Të hiqet nga lista shpronësimit për interes publik të pasurinë private me nr.7/198 e ndodhur në ZK 8572 që preket nga projekti "Sistemimi i sheshit dhe tregut fruta perimeve në lagjjen 'Skënder Libohova , rruga Pavarësia" në vlerën 707,208 lekë.

3. Të hiqen këto pasuri nga lista paraprake e pronarëve që shpronësohen nga projekti "Sistemimi i sheshit dhe tregut fruta perimeve në lagjjen 'Skënder Libohova , rruga Pavarësia".

4.Të miratohet lista paraprake me vlerën totale

Ngarkohet Komisioni i shpronësimeve për zbatimin dhe vazhdimin e procedurave të mëtejshme në Agjencinë Shtetërore për Shpronësim pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes.

DREJTORIA JURIDIKE

Bedri Hida

DREJTORIA PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Ariola Beqo

KRYETARI I BASHKISË

Eriselda Sefa

Adresa:Lagjia "Kongresi " Tel:+355 35 22213? E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com